KËRKESË
Nr. 1876/1, datë 7.4.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Tregu industrial ushqimor-markata", Berat.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" të ndryshuar. Për pronarët, sipas listës emërore bashkë-lidhur.

Pronarët, për të cilët është bërë shënimi "Saktësim dokumentacioni", do të likuidohen për efekt shpronë-simi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim,

Vlera gjithsej e shpronësimit për 5 (pesë) pronarë është 2,711,518 (dy milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

TABELA PËRMBLEDHËSE E SHPRONËSIMEVE PËR OBJEKTIN "TREGU INDUSTRIAL USHQIMOR-MARKATA", BERAT

Nr	Gjeneralitetet e pronarit	Ferdi Hajdar Dura	Hajrulla Shyqyri Dura	Beniamin Shyqyri Dura	Nuredin Fejzi Seitaj	Ylli Shaban Reka
1	Zona Kadastrale respektive	8502	8502	8502	8502	8502
2	Nr. I prones	8/139N1	8/139N2	8/139N3	8/139N4	8/155
3	Siperfaqa e truallit ne pronesi	5	5	12	10	
4	Siperfaqe ndertimore te objektit qe do te shpronesohet(faktike)	8.8	11.3	15.4	11.1	90
5	Siperfaqe ndertimore te objektit qe do te shpronesohet(sipas dokumentave te pronesise)	5	5	12	10	90
6	Cmimin per njesi te truallit sipas VKM nr.89 date 3.02.2016	4183	4183	4183	4183	
7	Vleren e truallit ne total qe do te shpronesohet	20915	20915	50196	41830	
8	Vlera e perllogaritur e nderteses sipas faktit(Vlera e preventivuar)	236,471	251,973	263,581	298,189	1,857,786
9	Vlera e perllogaritur (interpoluar) e nderteses sipas siperfaqeve te dokumentave te pronesise	134,358	111,492	205,387	268,639	1,857,786
10	Vlera totale per shpronesim(Truall+ ndertese sipas dokumentave te pronesise)	155,273	132,407	255,583	310,469	1,857,786
	Shuma gjithsej				**Leke**	**2,711,518**